



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr 5513 Prot.

Tiranë, më 20.08.2024

### NJOFTIM

**Drejtuar:** Autoriteteve / Enteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) njofton të gjithë autoritetet/entet kontraktore, Audituesit si dhe çdo Autoritet tjetër që në përbushje të detyrës së tij përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik (në vijim “SPE”) se, në datë 19.07.2024 janë bërë ndryshimet përkatëse në SPE me qëllim aplikimin e kufijve monetarë sipas parashikimeve të VKM Nr. 291/2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, për të gjithë elementët e regjistrat, të cilët janë krijuar në SPE përparrë implementimit të ndryshimeve në sistem, gjatë krijimit të dosjes së tenderit, në fushën “Kategoritë e kontratës” duhet të përzgjedhin tipin “Pa kategori”, me qëllim shfaqjen e të gjithë elementëve të regjistrat të krijuar.

Ndërsa, për elementet e regjistrat, të cilët do të krijohen pas implementimit të ndryshimeve në sistem, tek fusha “Kategoria e Kontratës” do të shfaqen kategoritë, si më poshtë:

- Kategoria “Klasike”, që do të përzgjidhet në rastin kur autoritetet/entet kontraktore prokuarjnë kontrata publike të lidhura ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, duke përashtuar kontratat sektoriale;
- Kategoria “Sektoriale” që do të përzgjidhet nga autoritetet/entet kontraktore, në rastin kur prokuarjnë sipas procedurave të prokurimit për kontratat sektoriale, si sektorët e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe atij postar, ndërmjet një ose më shumë operatorëve ekonomikë, që kanë si qëllim kryerjen e veprimit tarive, të përcaktuara në Kreun X të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar;
- “Pa Kategori”, që do të përzgjidhet në rastin kur elementi është krijuar për tipin e procedurës “Sistemi dinamik i biletave ajrore”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PERGJITHSHËM**

**Reida Kashta**

